

19/3
20.2.12



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 159/4 Prot

Tiranë, më 17.02 2017

DREJTUAR: Zj. Entela SHEHU
Drejtor i Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim


TIRANË

LËNDA: Dërgohet Raporti Final i Auditimit

Në mbështetje të Ligjit Nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe të Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 100, datë 25.10.2016, bashkangjitur ju dërgojmë Raportin Final të Auditimit të ushtruar në institucionin tuaj.

Gjithashtu, bazuar në pikën d, të nenit 12, të Ligjit Nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, “Plani i Veprimit” për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të angazhimit të auditimit, të miratohet nga titullari i institucionit dhe të dërgohet zyrtarisht në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm, jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga njohja me raportin final të auditimit, sipas formatit të sugjeruar nga ana jonë, bashkëngjitur raportit final të auditimit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,



RAPORT FINAL AUDITIMI

I. Permbledhje ekzekutive.

Bazuar ne Ligjin Nr. 114/2015 "Per Auditimin e Brendshem ne Sektorin Publik" dhe Manualin e Auditimit te Brendshem te miratuar nga Ministri i Financave me Urdher nr. 100, date 25.10.2016, sipas Programit te Auditimit miratuar me shkrese nr. 159/2 prot., date 23.01.2017, u krye auditim i plote ne Qendren Kombetare te Edukimit ne Vazhdim Tirane.

Auditimi u krye nga grupi i punes i perbere nga:

- Jorgji Qeramixhi, pergjegjes grupi.
- Zogulla Kote, specialiste auditimi.

Periudha e audituar: Janar 2014 – Dhjetor 2016

Afati i auditimit: 16.01.2017 – 3.02.2017

Teknika e kryerjes se auditimit: Me perzgjedhje.

Objekti i auditimit: Auditimi i sistemeve nga muaji Janar 2014 deri ne muajin Dhjetor 2016, per te vleresuar saktesine e regjistrimeve financiare, kryerjen e veprimeve ne perputhje me aktet ligjore ne fuqi dhe vleresimin e kontroleve te brendshme.

Auditimi eshte bazuar ne:

Ligji Nr. 9720, date 23.04.2007 "Per Auditimin e Brendshem ne Sektorin Publik", i ndryshuar me Ligjin Nr. 10318, date 16.09.2010 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin Nr. 9720, date 23.04.2007 "Per Auditimin e Brendshem ne Sektorin Publik".

Ligjin Nr. 114/2015 "Per Auditimin e Brendshem ne Sektorin Publik".

Manuali i Auditimit te Brendshem i miratuar nga Ministri i Financave nr. 100, date 26.10.2016 "Per miratimin e Manualit te Auditimit te Brendshem ne sektorin publik".

Ligji nr. 9936, date 26.06.2008 "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise".

Ligji nr. 10296, date 08.07.2010 "Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

Ligji nr. 9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar.

Ligji nr. 9228, date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", i ndryshuar.

VKM nr. 1, date 10.01.2007, "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar.

VKM nr. 918, date 29.12.2014, "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar
Udhezimi i Ministrise se Financave nr. 30, date 27.12.2011 "Per Menaxhimin e Aktiveve ne Njesite e Sektorit Publik" i ndryshuar.

Te ndryshme: Udhezime, Udhezues, Urdheresa dhe akte te tjera ligjore dhe nenligjore ne zbatim te ligjeve, vendimeve, urdherave ne fuqi.

Ne zbatim te procedurave te auditimit te brendshem ne date 15.01.2017 u zhvillua takimi fillestar me perfaqesuesit e institucionit. Ne kete takim nder te tjera u identifikuan sistemet dhe u dha nje panorame e shkurter e procedurave qe do te ndiqen nga grupi i auditimit.

Per identifikimin e sistemeve u bazuam ne raportet e meparshme te auditimit dhe ne strukturen organizative te institucionit.

Sistemet e identifikuar jane: sistemi i programimit dhe zbatimit te buxhetit; sistemi i menaxhimit te burimeve njerezore; sistemi i prokurimeve; sistemi i pagesave; sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar dhe zbatimi i rekomandimeve te lena nga auditimi i fundit. Gjithsej u identifikuan 5 sisteme.

Ne perfundim te kesaj procedure, grupi i auditimit bazuar ne sistemet e identifikuar plotesoi formatet standarte per vleresimin e kontrollit te brendshem dhe te risqeve per çdo sistem, kreu investigimin paraprak dhe ne fund pergatiti programin e auditimit.

Ne programin e miratuar u perfshine sistemet; sistemi i prokurimeve me vlere te vogel; sistemi i pagesave; sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar, sistemi i kontrollit te brendshem, Gjithashtu ne programin e auditimit u perfshi ndjekja dhe zbatimi i rekomandimeve te lena nga auditimi i fundit.

Ne perfundim, grupi i auditimit pasqyron vleresimin e sistemeve, respektivisht sipas programit te auditimit, si me poshte vijon:

Sistemi i kontabilitetit; Per kete sistemi rezultoi se sektori i finances nuk kishte celur regjistrin e riskut menaxhimit te aktiveve te ketij institucioni.

Per sistemin e prokurimeve: U konstatua se regjistrat e parashikimeve per vitin 2014, 2015 ishin raportuar ne organin qendror jashte afateve kohore dhe ne kundershtim me dispozitat ligjore ne fuqi per prokurimet publike.

Gjithashtu ky institucion nuk ka mbajtur regjistrin e riskut ku te pasqyroje sakte te gjitha qellimet dhe objektivat e institucionit ne perputhje me ligjin per menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Ne perfundim, grupi i auditimit pasqyron vleresimin e sistemeve, respektivisht sipas programit te auditimit, si me poshte vijon:

II. Hyrje.

Auditimi ne Qendren Kombetare te Edukimit ne Vazhdim Tirane, eshte realizuar mbeshtetur ne procedurat e percaktuara ne Manualin e Auditimit te Brendshem te miratuar me Urdherin e Ministrit te Financave nr. 100, date 25.10.2016 dhe ne perputhje me Standartet Nderkombetare per Praktiken Profesionale te Auditimit te Brendshem.

Qendra Kombetare e Edukimit ne Vazhdim Tirane (qe ketej e ne vazhdim do perkufizohet shkurtimisht QKEV) financohet nga buxheti i alokuar nga Ministria e Shendetesise. Gjate veprimtarise institucioni krijon te ardhura te cilat derdhen ne buxhetin e shtetit.

Ne perfundim te punes ne terren, u evidentuan gjetjet sipas rasteve, u vleresua funksionimi i kontrollit te brendshem duke pasur parasysh pese komponentet e tij si dhe u dhane rekomandimet e duhura me qellim qe objektivat te permbushen me kosto efektive dhe ne menyre efçente.

Ne kete menyre, grupi i punes permbushi objektivat e vena.

III. Objektivat e auditimit.

Auditimi financiar dhe i perputhshmerise ne QKEV Tirane, bazohet ne Ligjin nr. 114/2015 "Per Auditimin e Brendshem ne Sektorin Publik" dhe ne planin vjetor 2017 te miratuar nga Ministri i Shendetesise me shkrese nr. 4500 prot., date 27.10.2016.

Ne Programin e Auditimit miratuar me shkrese nr. 159/2 prot., date 23.01.2017, per çdo sistem u percaktuan qarte objektivat, te cilat kane te bejne me:

-vleresimin nese keto sisteme po veprojne ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi, udhezimet, urdherat, rregulloren e brendshme, strukturen organizative te miratuar dhe objektivat e vendosura nga Ministria e Shendetesise.

IV. Objekti i auditimit dhe metodologjia.

Objekt i auditimit u caktuan sistemet te cilat u identifikuan ne projekt programin e angazhimit, bazuar ne shqyrtimin e dosjes se auditimit te meparshem, ne takimin fillestar te organizuar me perfaqesuesit e institucionit ne date 15.01.2017, si dhe me vleresimin e riskut per çdo sistem. Gjithashtu pjese e programit eshte dhe sistemi i kontrollit te brendshem per te vleresuar nese jane vendosur dhe po funksionojne keto kontrole.

Per çdo sistem te mbuluar me auditim u perzgjedhen mbi 25 % te transaksioneve, procedurave te zhvilluara ose te veprimeve te kryera.

Metoda e perzgjedhjes ne menyre rastesore ose mbi baze risku u kombinua dhe me teknika te tjera si kontrolli aritmetik (liste pagesat, perlllogaritjen e pagave, faturat, situacionet etj), shqyrtimi i dokumentave justifikuese e krahasimi me dokumentin baze dhe ekzaminimin analitik (ne te gjithe sistemet e audituara sipas programit).

V. Gjetjet dhe konkluzionet.

Sistemi i kontrollit te brendshem.

Fushat te cilat u moren ne konsiderate gjate auditimit:

- *Hartimi dhe miratimi i rregullores se brendshme, ndarja e detyrave, pergjegjesive dhe linjat e raportimit.*

Institucioni operon sipas rregullores se brendshme e cila eshte derguar per miratim ne Ministrine e Shendetesise me shkrese nr.175 prot, date 14.04.2014. Kjo rregullore eshte e azhornuar ne perputhje me strukturen qe ky institucion ka.

- *Zbatimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit nepermjet komponenteve te nderlidhur me njeri tjetrin:*

*Mjedisi i kontrollit
Menaxhimi i riskut
Veprimtarite e kontrollit
Informacioni dhe komunikimi
Monitorimi*

Ne perfundim, nga auditimi ne Qendren Kombetare te Edukimit ne Vazhdim Tirane, rezultoi se kontrollet e brendshme kane funksionuar mire. Pavaresisht se njihet nga ana e stafit menaxherial Ligji nr. 10296, date 08.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin", jane shfaqur disa dobesi me nivel risku mesatar te cilat kane ardhur si pasoje e mungeses se kontroleve te brendshme.

Dobesite e konstatuara jane si pasoje gjithashtu dhe e mos njohja e dispozitave ligjore te nryshuara.

Mos azhornimi me dispozitat ligjore ndikon ne mjedisin e kontrollit i cili eshte nje nga komponentet e kontrollit te brendshem. Mjedisi i kontrollit i jep tonin institucionit, duke influencuar vetedijen kontrolluese te stafit. Ai perben themelin ku ngrihen te gjithe komponentet

e tjere te kontrollit te brendshem. Ne rregulloren e brendshme ishin shprehur qarte detyrat e e te gjithë punonjesve te institucionit.

Persa i perket menaxhimit te riskut nga ana e institucionit nuk eshte hartuar regjistri i riskut. Per kete komponent te kontrollit te brendshem nuk eshte hartuar regjistri por mbetet te permiresohet puna ne drejtim te hartimit dhe zbatimit te tij.

Aktivitetet e kontrollit nuk kane qene efektive ne te gjitha rastet, kjo e reflektuar ne gjetjet e konstatuara dhe te trajtuara ne paragrafet me poshte, dhe konkretisht ne sistemin e prokurimeve si dhe ne sistemin e kontabilitetit dhe raportimi financiar.

Informacioni dhe komunikimi, duhet te kuptohet si shkembim i informacioneve te dobishme ndermjet punonjesve te te gjithë niveleve si horizontalisht ashtu dhe vertikalisht. Gjithashtu informacioni eshte baza e komunikimit qe nevojitet per kryerjen efektive te detyrave te ngarkuara. Pra ne disa raste informacioni nuk permban hollesi te mjaftueshme dhe te jete i pershtatshem per perdoruesin; kjo eshte verejtur me shume gjate auditimit te sistemit te kontabilitetit dhe raportimit financiar.

Monitorimi ka qene aq efektiv ne te gjitha nivelet menaxheriale.

Nga auditimi rezultoi gjithashtu se ne disa raste keto kontrole nuk kane funksionuar siç duhet, duke siguruar zbatimin e parimit te ligjshmerise, rregullave dhe procedurave.

Sistemi i prokurimeve.

Objektivi i auditimit:

Vleresimi nese prokurimet publike jane kryer ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Fushat qe do te merren ne konsiderate gjate auditimit:

Realizimi i prokurimeve per mallra e sherbime ne perputhje me regjistrin e parashikimit te prokurimeve publike.

Respektimi i procedurave te prokurimeve qe nga perzgjedhja e procedures e deri ne lidhjen e kontrates.

Respektimi i kushteve te percaktuara ne kontrate per likuidim.

Titullari i Autoritetit Kontraktor me shkrese nr. 25/1 prot, date 21.01.2014 ka derguar ne Ministrine e Shendetesise regjistrin e parashikimit te prokurimeve publike per vitin 2014. Regjistri i parashikimit te prokurimeve publike per vitin 2015 eshte derguar ne Ministrine e Shendetesise me shkrese nr. 6/1 prot, date 19.01.2015.

Regjistrat e parashikimeve te prokurimit publik jane derguar ne Ministrine e Shendetesise jashte afatit kohor te parashikuar ne nenin 5 te VKM-se nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" i ndryshuar dhe per kete ngarkohet me pergjegjesi Nepunesi Autorizues dhe Nepunesi Zbatues.

Regjistrat e realizimit te prokurimit publik per vitin 2014, 2015 dhe 2016 jane hartuar dhe derguar ne Ministrine e Shendetesise ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

Per sistemin e prokurimeve me vlere te vogel u perzgjedhen kampione per auditim nga blerjet e vogla te muajeve Nentor-Qershor-Prill 2014; Shkurt-Maj-Gusht 2015 dhe muajt Mars-Prill-Tetor 2016.

Nga auditimi i procedurave me vlere te vogel u konstatua se perpara fillimit te procedurave te prokurimit ishin hartuar kerkesat per pune/mallra apo sherbim, titullari kishte nxjerre urdher

prokurimin me fond limit te percaktuar, ishte bere shpallja per pjesemarrje ne tender, ishte shpallur fituesi sipas ofertes me te vogel, ishte ngritur komisioni i marrjes ne dorezim te mallit si dhe me pas afatit te levrimit te mallit ishte bere likuidimi i faturave.

Nisur nga kjo theksojme se per sistemin e prokurimeve me vlere te vogel nuk rezultuan gjetje.

Per kete sherbim vleresojme se nuk jane konstatuar gjetje te cilat mund te cenojne objektivat e institucionit. Theksojme se sistemi i kontrollit te brendshem ka funksionuar ne drejtim te mbyqyrjes, ndarjes te pergjegjesive te punes dhe zbatimin e akteve ligjore te cilat kane sjelle dobi dhe eficence ne perdorimin e fondeve publike.

Sistemi i pagesave.

Objektivi i auditimit:

Vleresimi nese pagesat jane kryer konform Ligjit per buxhetin dhe udhezimeve perkatese nga Ministria e Finances per zbatimin e buxhetit.

Fushat qe do te merren ne konsiderate gjate auditimit:

Dokumentimi financiar i te gjithë transaksioneve apo pagesave te kryera duke filluar nga kerkesat per punen apo sherbimin e nevojshem deri ne likujdimin e faturave tatimore ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

Regjistrimi i te gjithë transaksioneve te kryera ne ditarin e bankes per emertesën, vlerën dhe llogarinë kontabile.

Per sistemin e pagesave u perzgjedhen kampione per auditim nga muajt Nentor-Qershor-Prill 2014; Shkurt-Maj-Gusht 2015 dhe muajt Mars-Prill-Tetor 2016.

Per te gjithë transaksionet e perzgjedhur per auditim si me siper u konsatua se transaksionet jane kryer sipas te gjithë dokumentacioneve justifikuese dhe vertetuese. Bashkengjitur me urdher shpenzimin ishin faturat perkatese dhe te gjithë dokumentacionet plotesuese te cilet vertetonin me se mire kryerjen e ketyre transaksioneve.

Te gjithë transaksionet e perzgjedhur per auditim ishin te regjistruar ne ditarin e bankes sipas emertesës, vleres dhe sipas llogarive kontabile perkatese dhe ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

Ne perfundim te auditimit te dokumentacionit te pagesave vleresojme se dokumentimi dhe regjistrimi i transaksioneve e pagesave eshte kryer ne rregull dhe ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar.

Objektivi i auditimit:

Vleresimi nese regjistrimi i veprimeve financiare dhe nxjerrja e pasqyrave financiare eshte kryer ne perputhje me aktet ligjore ne fuqi per kontabilitetin.

Fushat te cilat do te merren ne konsiderate gjate auditimit:

Procedurat e kryerjes se inventarizimit dhe pasqyrimi ne bilanc sipas llogarive perkatese.

Regjistrimi i veprimeve financiare ne ditaret perkates te kontabilitetit

Pasqyrimi ne bilanc i te drejtave /detyrimeve.

a. Procedurat e kryerjes se inventarizimit dhe pasqyrimi ne bilanc sipas llogarive perkatese.

Per periudhen e audituar rezultoi se nga drejtuesit e institucionit ishin ngritur komisionet per kryerjen e inventarizimit ne fund te cdo viti ku vlera kontable ishte e barabarte me vleren fizike. Nga shqyrtimi i bilancit rezulton se shumet ne fund te cdo viti ishin pakesuar ose shtuar ne bilanc, veprimet arithmetike jane kryer ne rregull, te kuadruara dhe shuma e aktivitet eshte e barabarte me shumen e pasivit.

Te dhena mbi AAM (Aktivet afat gjata materiale).

Nr llog	Vlera bilancit 2013	Vlera bilancit 2014	Vlera bilancit 2015
212	0	0	0
214	0	0	0
215	2.033.200	2.033.200	2.033.200
218	6.453.683	6.453.683	6.453.683
shuma			

Sic shihet dhe nga tabela logaria 212 "Ndertime e konstruksione" vlera e bilancit per te tre vitet eshte zero pasi QKEV eshte e akomoduar ne zyrat e ISHP-se qe prej krijimit te saj si institucion. Llogaria 214 "Istalime teknike, makineri, paisje, vegla pune" paraqitet me vleren zero sepse kondicioneret ne shumen 255.100 leke nga shefja e finances jane pasqyruar te llogaria 218 "Iventar ekonomik" nderkohe qe duhet te ishin paqyruar te llogaria 214 "Istalime teknike, makineri, paisje, vegla pune".

b. Regjistrimi i veprimtarive financiare ne ditaret perkatese te kontabilitetit.

Mbajtja e kontabilitetit dhe regjistrimi i veprimeve financiare eshte kryer ne perputhje me Ligjin nr. 9228 date 29.04.2004 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar.

Veprimet financiare jane regjistruar ne ditaret perkates si; ditari i bankes, ditari i magazines, ditari i hyrjeve dhe daljeve ne te cilat jane debituar dhe kredituar sakte llogarite perkatese.

Veprimet e kryera jane te shoqeruara me dokumentacionin justifikues (fatura, flete hyrje, flete dalje).

Nga ky institucion nuk ishte krijuar regjistri i riskut per menaxhimin e aktiveve. Aktivitet duhet te menaxhohen njesoj sic do pjese tjeter e punes se njesise, qe do te thote duhet te ekzistojne sistemet e kontrollit dhe informacionit nese mjetet monetare jane shpenzuar me eficence, efektivitet dhe ekonomi. Keto veprime jane kryer ne kundërshtim me Udhëzimin e Ministrise se Financave nr. 30, date 27.12.2011 "Per menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit publik" i ndryshuar, Kreu II, pika 17, 18, 19, 20 dhe ngarkon me pergjegjesi Nepunesin Autorizues dhe Nepunesin Zbatues.

c. Pasqyrimi ne bilanc i te drejtave /detyrimeve.

Per kete fushe auditimi u krye lidhur me evidentimin e sakte te drejtave dhe detyrimeve ne llogarite, klasa 4 (Kerkesa arketimi mbi debitoret ose kreditore).

Ne bilancet e viteve 2013, 2014, 2015 ishin pasqyruar te drejtat dhe detyrimet sipas llogarive perkatese dhe konkretisht sipas tabelës se meposhtme:

Llogaria	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015
467	996.500	661.500	312.500

401	47.718	28.281	59.976
421	913.848	1.001.252	894.402
431	119.326	79.768	70.296
435	301.161	294.914	259.712
436	41.790	41.374	36.957
TOTAL			

Pra sa me siper ky institucion nuk ka te drejta te prapambetura te pa arketuara kurse te llogaria 467 "Kreditor te ndryshem" shuma respektive i takojne detyrimeve qe institucioni ka ndaj ekspertve te pavarur. Keto detyrime jane krijuar nga mos paraqitja nga ekspertet te numerave te llogarise si dhe detyrimet ne fund te vitit.

Ne pasiv te bilancit ne klasen 4 "kreditore" jane pasqyruar detyrimet e institucionit ndaj punonjesve per pagat dhe sigurimet shoqerore e shendetesore te muajit dhjetor, te paguara ne muajin janar te vitit pasardhes si dhe detyrime ndja shtetit per tatim taksa.

Ne perfundim te auditimit vleresojme se sistemi i kontabilitetit ka funksionuar ne drejtim te kontrollit te brendshem si ne mjedisin e kontrollit ashtu dhe ne aktivitetet e kontrollit

Te tjera.

- Zbatimi i rekomandimeve te lena nga auditimi i fundit.

Sipas Raportit Final te auditimit paraardhes derguar me shkresen nr. 4848/4 prot, date 23.12.2013 jane lene per zbatim shtatembedhjete rekomandime. Nga auditimi rezultoi se te gjithë rekomandimet kishin gjetur zbatim.

VI. Plani i veprimit.

Ne perfundim te procesit te vleresimeve te bera nga grupi i auditimit, bazuar ne Ligjin nr. 114/2015 "Per auditimin e brendshem ne sektorin publik", per arritjen e objektivave te Drejtorise se Shendetit Publik Lushnje, si dhe per te rritur efektivitetin ne punen, funksionimin dhe drejtimin e ketij institucioni, **rekomandojme:**

1. Te hartohet regjistri i riskut ku te percaktohet qarte niveli i saj ne menyre te tille qe te mos cenohet arritja e objektivave nga institucioni. Ky regjister duhet te jete pjese integrale e regjistrit te riskut te Ministrise se Shendetesise.

Nepunesi Autorizues, Nepunesi Zbatues

Afati: Menjehere.

2. Te çelet e regjistri i menaxhimit te riskut te aktiveve. Nga nepunesi zbatues te ngrihen kontrollet e brendshme te domosdoshme per mirefunksionimin e sistemit kontabel e financiar.

Nepunesi Zbatues

Afati: Menjehere.

3. Ne bilancin e vitit 2016 te sistemohet shuma 255.100 leke (kondicionere) nga llogaria 2018 "Inventar ekonomik" ne llogarine 214 "Instalime teknike, makineri, paisje dhe vegla pune"

Nepunesi Zbatues

Afati: Menjehere.

VII. Komentet e subjektit te audituar.

Ne projekt raportin e nenshkruar nga punonjesit e institucionet nuk kishte observacione lidhur me gjetjet dhe konkluzionet e lena nga auditimi.

VIII. Falenderime.


Per permbushjen e objektivave te auditimit, grupi i punes falenderon zj. Entela Shehu, Drejtor i Qendres Kombetare te Edukimit ne Vazhdim dhe stafin e tij, per gadishmerine qe treguan per venien ne dispozicion te dokumentacionit, suportin logjistik dhe bashkepunimin gjate punes ne terren.

Raporti final i auditimit hartohet ne tre kopje, prej te cilave njeh kopje i dergohet institucionit te audituar, njeh kopje ruhet ne protokoll dhe njeh kopje ruhet ne dosjen e auditimit.

Grupi i auditimit

Jorgji Qeramixhi

Zogulla Koto



Plan veprimi i sugjeruar.

Plotesohet nga Njesia e Audituar per kolonen numer 5, 6, 7.

Numri i rektan.	Rekomandimet	Renditja sipas nivelit	Referenca e paragrafit ne raport	Reagimi menaxhimit subjektit audituar	Afati i percaktuar	Personat pergjegjes per realizimin e rekomandimeve.
1	Te hartohet regjistri i riskut ku te percaktohet qarte niveli i saj ne menyre te tille qe te mos cenohet arritja e objektivave nga institucionet. Ky regjister duhet te jete pjese integrale e regjistrit te riskut te Ministrise se Shendetesise.	I mesem	Faqe 4 Paragrafi 1			
2	Te çelet e regjistri i menaxhimit te riskut te aktiveve. Nga nepunesi zbatues te ngrihen kontrollet e brendshme te domosdoshme per mirefunksionimin e sistemit kontabel e financiar.	I mesem	Faqe 6 Paragrafi 3			
3	Ne bilancin e vitit 2016 te sistemohet shuma 255.100 leke (kondicionere) nga llogaria 2018 "Inventar ekonomik" ne llogarine	I mesem	Faqe 6 Paragrafi 2			

Plan veprimi i sugjeruar.

Plotesohet nga Njesia e Audituar per kolonen numer 5, 6, 7.

	214 “Instalime teknike, makineri, paisje dhe vegla pune”								

DREJTORI

Entela Shehu